




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



ABC

AVDULAJ BAILIFF SERVICES

Nr. 82 .Prot  
Nr.164 Regj.

Tirane, me date 02.03.2017

**URDHER**

**PER VENDOSJEN E MASES SE SEKUESTROS KONSERVATIVE**

**Drejtuar: Qendres Kombetare Biznesit**  
**Adresa: Tirane**  
**Per dijeni: Arben Petto**

Prane Zyres Permbarimore "Avdulaj Bailiff Services", me Permbarues Gjyqesor Privat Z. Jetlir Avdulaj eshte depozituar kerkesa e pales kreditore Raiffeisen Bank sh.a ne date 15.06.2016, per rifillimin e procedures permbarimore per ekzekutimin e Urdherit te Ekzekutimit Nr. 1038 Akti, date 18.02.2013 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, leshuar per Kontraten e Kredise me Kufi Nr. 2339 rep, Nr. 1016 kol, date 14.05.2011 (se bashku me ndryshimet), me pale:

- Kreditor: Raiffeisen Bank**
- Debitor: Shoqeria "BI Investement" shpk**  
**Shoqeria "Instituti i Studimeve dhe Projektive Pyjore" sh.a**  
**Shoqeria "Ben Impex & Co" shpk, Shoqeria "I.S.S.P" shpk**
- Dorezanes: Arben Petto, Shoqeria "Kelti" shpk, Diana Petto**
- Hipotekues: Arben Petto, Diana Petto, Shoqeria "BI Investement" sh.p.k**
- Objekti: Kthim Kredie**

Ne kushtet kur nga pala debitore, nuk eshte kryer ekzekutimi i Urdherit te Ekzekutimit Nr. 1038 Akti, date 18.02.2013 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, leshuar per Kontraten e Kredise me Kufi Nr. 2339 rep, Nr. 1016 kol, date 14.05.2011 (se bashku me ndryshimet), nga ana e zyres permbarimore, duhet te kryhet bllokimi i aktiveve te regjistruara te pales debitore.

**Ne zbatim te neneve 527 e ne vijim te Kodit te Procedures Civile dhe Ligjit Nr. 10031 date 11.12.2008 "Per Sherbimin Permbarimor Gjyqesor Privat".**

**URDHEROJ**

1-Qendra Kombetare e Biznesit te beje bllokimin e kuotave/aktiveve te regjistruara ne emer te Arben Petto, deri ne nje urdher te dyte, ne shoqerite:

**BI-SERVIS shpk, me NIPT: K41614010T**  
**TRUST PARTNERS shpk, me NIPT:K61717025R**

2-Per veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini ne dijeni shkreserisht brenda afatit ligjor.

3-Personat qe behen pengese, do te pergjigjen sipas dispozitave te Kodit Penal dhe nenit 606 (paragrafi II) e ne vijim te Kodit te Procedures Civile.

4-Ky urdher mbahet ne 4 kopje, dhe u njoftohet paleve te cilat kane te drejten e ankimit ne Gjykate brenda 5 diteve.

**Permbaues Gjyqesor Privat**  
**JETLIR AVDULAJ**

